





01-1106

	<p style="text-align: center;">Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p style="text-align: center;">Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina</p>	<p style="text-align: center;">PRISHTINA</p> 
---	--	--

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-145530/22 dt. 24.06.2022, të pronarëve Xhemajl Krasniqi dhe Enver Aliu nga Prishtina dhe investitorit N.T.SH. “Alb Petrol” me adresë në Gllamnik, Komuna Podujevë, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shumë banesore me afarizëm, ndërtuar në kuadër të bllokut urbanistik urban “B8-2” të tërësisë urbane “B”, të Planit Rregullues Ndryshimi dhe Plotësimi “Arbëria 3”, në rrugën “Ahmet Krasniqi” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 14.06.2024, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET Xhemajl Krasniqi dhe Enver Aliu nga Prishtina dhe investitorit N.T.SH. “Alb Petrol” me adresë në Gllamnik, Komuna Podujevë, me certifikatë të regjistrimit ARBK 810431320, me përfaqësues Idriz Ejupi, sipas kërkesës 05 Nr.391/02-145530/22 dt. 24.06.2022, përdorimi i ndërtesës shumë banesore me afarizëm, të emërtuar si “Objekti 2” me etazhitet të shkallëzuar B+S+P+4/5/6ET, e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-232023/17 dt. 13.11.2017, në kuadër të bllokut urban “B8-2” të tërësisë urbane “B” të Planit Rregullues Ndryshimi dhe Plotësimi “Arbëria 3”, konkretisht në parcelën kadastrale nr. 10231-0, ZK Prishtinë.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhen në rrugët “Ahmet Krasniqi” ku janë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: 230, 230/1, 232, 232/1, 234, 240/3, 240/4 dhe 240/5 në Prishtinë, dhe e njëjta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

Ar sy e t i m

Pronarët Xhemajl Krasniqi dhe Enver Aliu nga Prishtina dhe investitori N.T.SH. "Alb Petrol" me adresë në Gllamnik, Komuna Podujevë, me certifikatë të regjistrimit ARBK 810431320, me përfaqësues Idriz Ejupi, me kërkesën me 05 Nr.391/02-145530/22 dt. 24.06.2022, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën shumë banesore me afarizëm, të emërtuar si "Objekti 2" me etazhitet të shkallëzuar B+S+P+4/5/6ET, e ndërtuar në kuadër të bllokut urban "B8-2" të tërësisë urbane "B" të Planit Rregullues Ndryshimi dhe Plotësimi "Arbëria 3", konkretisht në parcelën kadastrale nr. 1010175-1, ZK Prishtinë, ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-232023/17 dt. 13.11.2017 dhe të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit e Komunës së Prishtinës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë, me referencë 09 Nr. 391/02-219745/21 dt. 23.03.2021, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Njoftimin mbi Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimin të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografii gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të ndërtesës, nga udhëheqësi i punishtës Nazim Hajrizaj; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Ahmet Aliu; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Nazim Hajrizaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Astrit Salihu; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektrike, nga mbikëqyrësi Valbone Osmani; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Rifat Lutolli; Raportin e përfundimit të punëve për mbrojtje nga zjarri, nga Nazim Bajrami, Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga kompania e licencuar për kryerjen e matjeve kadastrale "Geomatika-Arch" Sh.p.k. me nr. të licencës 01.

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesat shumë banesore me afarizëm mund të përdoren.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat

nga Ligji për Ndërtim nr. 04/L-110, janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesën shumë banesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI

Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-145530/22 DT. 14.06.2024**

Zyrtari,
Berim Osmanaj

Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi



